KËRKIMET | FAKTE













Të dhëna të reja mbi krishtërimin e hershëm në Berat

Një studim i hollësishëm dhe sistematik gjatë këtyre 7 viteve të fundit mbi gjurmime e gjurmë të skulpturës arkitekturore që ka ekzistuar në ambjentet e kishave dhe kalanë e Beratit...

Nga Dritan ÇOKU

Në fushën e studimit të ndër timeve arkitektonike të pe riudhës së vonë antike (284-565) dhe të hershme mesjetare (565-850) në qytetin e Beratit, paraqitet një interes i veçantë për njohjen më të plotë të saj, pasi siç e dimë mungojnë të dhënat burimore.

Në Berat janë gjetur një numër i konsiderueshëm i skulpturës arkitekturore, të cilat për nga numri dhe shumëllojshmëria e tyre dëshmojnë për një numër jo të vogël monumentesh, si dhe rëndësinë e qytetit në Antikitetin e Vonë.

Nuk është e vërtetë sipas përmendjes të së njëjtës fraze dy herë në literaturë, që "Asgjë nuk gjendet në qytetin e Beratit që të dëshmojë arkitekturën paleokristiane, veçse tri kapitele. I pari është si tryezë altari në kishën e shën Kollit pranë Vllahernës (fig.1): i dyti është një kolonë e vogël me kapitel të vendosur përmbys në dritaren e absidës së kishës së shën Todrit në kala (fig.2). Në rastin e dytë mund të thuhet me siguri se ndërtesa nga është marrë ka qenë ndërkohë e prishur (mesi i shekullit XVI). I treti është gjetje e rastit (fig.3)". (A.Baçe, A.Meksi, E.Riza, "Berati historia dhe arkitektura", Tiranë, 1988, f.5, dhe revista periodike "Art dhe Trashëgimi", Prof. Dr. Aleksandër Meksi "Ndërtimet e kultit të krishterë në qytetin e Beratit", 2011, f.45).

Në revistën periodike shkencore "Monumentet" 2/1990, në artikullin "Disa dëshmi të periudhës së hershme bizantine në Berat", f. 114-116 nga Prof. Dr. Guntram Koch përveç 3 elementeve të përmendur më sipër, u shtohen edhe tre kollonat që ndodhen në kishën e shën Todrit (fig.4), shën Mëri Vllahernës (fig.5) dhe shën Kollit (fig.6) në kalanë e Beratit, një pllakë guri e cila është e përdorur













në absidën e shën Todrit (fig.7), dhe një fragment i rëndësishëm i reliefit plastik (fig.8) për të cilën Koch flet shkurtimisht në atë shkrim. Sipas Prof. Dr. Guntram Koch, për formën e kollonave sakt ësson përdorimin e shprehjes "Kollona dyfishe". Kjo formë është tipike për ndarjet e dritareve në kishat paleokristiane dhe të hershme bizantine. Për pllakën e gurit, Koch na informon se duhet të ketë qenë pllakë parmaku që i përkiste Templonit të një kishe bizantine të hershme të ndërtuar në gjysmën e parë të shek.VI. Ndërsa për fragmentin e rëndësishëm të reliefit plastik, është një objekt i përdorur për qëllime të kultit të krishterë, sipas tij kemi të bëjmë me një relikuar, pra me një mbajtës relikesh të një apo më shumë shenjtorësh. Ai mendon se ky relikuar duhet ti takojë periudhës së dytë të lulëzimit të qytetit, pikërisht çerekut të dytë të shek.VI.

Shembuj të skalitur në mermer na ofron edhe restauratorja e artit znj. Fatbardha Shkupi mbi një fragment frizi të shek.VI (gjetur tek Hysen Qalliu në lagjen "Murat Çelebi"). (Fatbardha Shkupi, Mjeshtrit popullorë në Berat gjatë shekujve 18-19 dhe fillimit të shek.20, Monumentet 2/1990, GRAFIKA ARS, Tiranë, 1990, f.57) Objekti në fjalë edhe gjatë përmendjes në literaturë nuk është i ilustruar, gjë që na bënë akoma më shumë përgjegjës mbi dokumentimin, katalogimin, njohjen e tyre nga ana pamore, për të na shërbyer në studime më të thelluara.

Mozaiku, sidomos në kisha janë realizuar në vartësi të trajtimit arkitekturor. Pozicionimi i tyre shpreh një botkuptim duke u lidhur edhe nga ana simbolike. Përveç kësaj ai luante rolin dekorativ duke u harmonizuar me pikturën murore dhe ikonostasin.

Në qytetin e Beratit dëshmitë...

vijon në faqen 18

vijon nga faqja 17

...më të hershme për prezencën e mozaikut deri tani është ajo që është gjetur brenda rrethimit të tretë të kalasë së Beratit. Kjo mbetje mozaiku i përket antikitetit të vonë, dhe është punuar me gurë polikromë (fig.9). Duke e krahasuar nga simbolika gjejmë paralele me mozaikun e Apolonisë, një nga mozaikët e godinës termale (shek.III), me mozaikun e një bazilike të shek.V në Tepë të Elbasanit, me elemente dekorative të mozaikut të Tiranës dhe gjithashtu edhe me mozaikun e Ohnesmios (shek.V-VI). (Dritan Çoku,Gjurmë e një sinagoge në kalanë e Beratit, bocet, Berat, 2012, f.43)

Nuk mund të rri këtu pa përmendur dhe artikullin shkruar më 13 Maj 2012, i cili është botuar në "Gazetën Shqiptare" suplementin "Milosao" me titull "Kishat e kalasë së Beratit" të Ing.Rest. Genci Samimit, i cili na parashtron jo vetëm saktësinë shkencore të së vërtetës së numrit të kishave të kalasë së Beratit, por përmend edhe një kapitel paleokristian (fig.10) (gjë që nuk e kishte evidentuar njeri më parë) të vendosur në muraturën e kishës së shën Mëri Vllahernës. Sipas tij çlirimi i oborrit të kishës do të sjellë të dhëna shumë të vlefshme për vetë monumentin, historinë e tij, por edhe për historinë e kalasë.


Në brendësi të kishës së shën Triadhës janë përdorur dy kolona me dy kapitelet që sëbashku me dy pilastra të ndërtuara me gurë të çrregullt shërbejnë për krijimin e mbështetjes së tamburit në këtë kishë. Kolona nga veriu është prej mermeri gri me damarë të bardhë dhe ka një kapitel jonik (fig.11) prej guri gëlqeror dhe pak të dëmtuar. Kolona nga jugu është edhe ajo prej mermeri, por më e hollë dhe më e shkurtër. Për këtë arsye janë përdorur gurë, si bazament, ashtu dhe nën kapitelin korintik (fig.12) më të vogël se struktura mbi të. (Aleksandër Meksi, Tri kishat bizantine të Beratit, "Monumentet" 4, 1972, Mihal Duri, Tiranë, 1972, f.63)

Mbi këto hulumtime në literaturë numri i kësaj skulpture arkitekturore shkon në 15-të. Këtij numri mund t'i shtohet në këtë rast edhe kodeksi i purpurt (Beratinus 1) (fig.13), i cili sëbashku me kodikun e artë të Anthimit janë regjistruar në regjistrin e "Kujtesës së Botës" si vlera unikale të njerëzimit që mbrohen tashmë nga UNESCO. Ky kodeks që trashëgojmë dëshmon për periudhën e antikitetit të vonë, që na intereson.

Pra, numrit 16-të të tyre tanimë është rritur, jo si pasojë e gërmimeve arkeologjike, që fatkeqësisht mungojnë prej disa dekadash në qytetin e Beratit, për të hedhur dritë në këtë periudhë të historisë së qytetit, por prej një studimi të hollësishëm dhe sistematik gjatë këtyre 7 viteve të fundit mbi gjurmime e gjurmë të kësaj skulpture arkitekturore që kanë ekzistuar në ambjentet e kishave në kalanë e Beratit, disa prej tyre të ripërdorura, dhe disa të vendosura në interieret e tyre, duke mos u vrojtuar me kujdes dhe duke mos ju dhënë rëndësia e duhur, për t'u thelluar dhe më pas studiuar.









GJETJET:

Kisha e shën Todrit K-003

Pranë pllakës së gurit që është përdorur në absidën e shën Todrit, na bëri përshtypje një gurë në formën e një prizmi me bazë drejtkëndore. Ai është një kapitel (fig.14), në të dyja brinjët më të vogla të së cilit ishte i gdhendur nga një kryq. Këto kapitele, janë të përhapur në periudhën paleokristiane dhe të hershme bizantine. Pjesa e elementit të sipërm të kryqit është e dëmtuar. Ky kapitel është i ngjashëm me kapitelin që ka evidentuar Ing.Rest.Genci Samimi në kishën e shën Mëri Vllahernës, jo vetëm për nga forma dhe përmasat, por edhe për nga realizimi i dekorimit të gurit me simbolin e kryqit. Po kështu mbi absidën e kishës së shën Todrit janë tre tjegulla solene me gjatësia 54cm gjerësia 40cm dhe trashësi 2cm (fig.15). Duke bërë paralele me tjegulla të cilat janë përdorur në kishat paleokristiane mendojmë se edhe ato janë të kësaj periudhe. (Dritan Çoku, Gjurmë e një sinagoge në kalanë e Beratit, bocet, Berat, 2012, f.81)

Kisha e shën Kollit pranë Vllahernës K-114

Është një kishë e vogël, mbështetur mureve të taracimit, pjesë e pandarë e strukturës urbanistike të lagjes kala. Për këtë arsye absida e kishës është e mbuluar nën terrenin në lindje të kishës. (Aleksandër Meksi, Pirro Thomo, Arkitektura pasbizantine në Shqipëri, "Monumentet" 19, 1980, Mihal Duri, Tiranë, 1980, f.91) Një të dhënë epigrafike zbuluam në një pllakë qeramike (fig.16) e përdorur si bazë tek protezisi, e cila ka një kryq që është formuar nga prerja e dy diagonaleve të pllakës dhe brenda hapësirave të tij ka shkrime në greqisht. Kryqi dhe shkrimet në greqisht është kryer i lirë me anë të vizatimit me gisht. Brenda hapësirave të kryqit dhe saktësisht tek pjesa përpara është shkruar CëßÓ×Øù: në hapsirën në të djathtë ndodhen....ëñ: ndërsa në të katër hapësirat është përdorur shkronja ô.

Kisha e shën Mërisë Fjetur, sot muzeu Ikonografik "ONUFRI" K-081

Një kapitel tjetër relativisht i madh ndodhet në interierin e kishës së shën Mërisë së Fjetur, sot muzeu Ikonografik "ONUFRI" në kalanë e Beratit. Është vendosur mbi një pjesë së dyshemesë së kishës, për momentin shërben si bazë e ekspozimit të një ikone. Ky kapitel me impost jonik (fig.17) ka formën e një prizmi me faqe trapezi. Në njerën prej faqeve është i dëmtuar, ndërsa në faqen përkrah kësaj të fundit është përdorur brenda bordurës së një rombi ornamenti me simbolin e një kryqi dhe i katër petaleve në hapësirat e kryqit. Në të majtë dhe të djathtë të kulmit të poshtëm të rombit janë dekoruar motive gjethesh. Kapitelet jonike me impost, janë përdorur para së gjithash në emporet e bazilikave paleokristiane dhe të hershme bizantine. (Guntram Koch, Disa dëshmi të periudhës së hershme bizantine në Berat, "Monumentet" 2/1990, GRAFIKA ARS, Tiranë, 1990, f.116)

Duke bërë krahasime me kapitelet jonike me impost të bazilikës së Ballshit, me katër kapitelet të cilat janë të ndryshme nga njeri-tjetri në kishën e shën Kollit në Perondi, që mund të jenë mbetje të kishave të mëdha e të kushtueshme nga Berati, që u ndërtuan në shek.VI, por mund të shkojmë edhe më tutje në rrënojat e bazilikës në ishullin Lesbos dhe rrënojat e bazilikës paleokristiane së Agia Fotini në ishullin Karpathos Greqi, plastika dekorative arkitektonike e kapitelit tonë qëndron më lart nga ana artistike me një punim më fin. Nuk e dimë a mund të jetë element arkitektonik që i takonte ndonjë objekti të zhdukur në kalanë e Beratit për të nxierrë përfundime të mëtejshme?, sepse kapiteli është mjaft interesant për nga tipologjia, dhe mjaft me rëndësi për t'u studiuar. Dekoracioni i përdorur në të, është i ngjashëm me motivin e përdorur në një mozaik të shek. II në Shikmona (fig.18) e cila ndodhet në afërsi të bregut të detit në hyrjen jugore të qytetit modern Haifa, Izrael.

Njohja, thellimi dhe studimi i mëtejshëm i tyre do të jetë padyshim një kontribut i vlefshëm mbi dokumentimin dhe sqarimin e problemeve që lidhen direkte me origjinën e këtyre elementeve arkitektonike dhe traditën e ndërtimeve të antikitetit të vonë në qytetin e Beratit.







Pranë mëngrës së Nanos K-051 në lagjen "Kala"

Tek mëngra nga ana lindore e kalasë së Beratit në një grumbull gurësh në afërsi të kullës që ndodhet aty pranë evidentuam sëbashku me arkeologun Elton Xheka një bazament kolone (fig.19), e cila u transportua dhe sot gjendet në ambjentet e Drejtorisë së Monumenteve të Beratit. Duke e vrojtuar me kujdes dhe duke studiuar kishat e kalasë së Beratit, ky bazament, i cili është prej guri gëlqeror mendojmë se nuk i përkon asnjë objekti kulti që ekziston sot në kala, që përkatësisht mbajnë datimet e ndërtimit ose rikon-


20


22


21


23




24


25

struksioneve nga shek.XIII-shek.XIX. Nga forma bazamenti është gjysëm, i punuar dhe përfunduar me qëllim për t'u vendosur sëbashku me kollonën dhe kapitelin mbështetur në faqen e murit në hyrjen e ndonjë balline të ndonjë ndërtimi të hershëm. Ai mund t'i përkasë, ndonjë ndërtimi të zhdukur në kalanë e Beratit që u ndërtuan në shek.VI.

Kisha e shën Mëhillit M-003

Ngrihet në një breg mjaft të ngushtë me shkëmbin e thepisur të kalasë, në anë të lagjes "Mangalem", me anën veriore të saj të mbështetur në faqen e shkëmbit. Përmasat e terrenit, nevoja për një rrugë kalimi e hyrje në kishë si dhe për një shesh të vogël përpara saj kanë përcaktuar madhësinë e objektit, që paraqet një kapelë të tipit kryq i brendashkruar pa mbështetje të lira, me kupolë mbi tambur. (A.Baçe, A.Meksi, E.Riza, Berati historia dhe arkitektura,"8 Nëntori", Tiranë, 1988, f.55) Disa metra sipër gjendet një shpellë e vogël, e quajtur shpella e shën Mëhillit (fig.20), muret e së cilës, siç tregojnë ende gjurmët, kanë qenë dikur të veshur me piktura mozaiku. Vendi i kultit në shpellë është më i vjetër se kishëza e që të dy duket se shtyhen thellë gjer në kohën e hershme bizantine. (Eqrem bej Vlora, Ditar (nga Berati në Tomorr dhe kthim), KOÇI, Tiranë, 2003, f.55) Kjo shpellë është e ndarë në dy ambjente: ambjenti i parë në krahë sipër kishës ku ndodhet absida dhe një protezis: ambjenti i dytë përdoret si ambjent ndihmës i kishës së shën Mëhillit, por mendojmë se aty mund të ketë qenë fillesa i një objekti të hershëm kulti të krishterë, ku vrojtojmë edhe një birë artificiale në shkëmb (fig.21), e cila është daltuar dhe realizuar me qëllim, për t'i dhënë funksionin e një protezisi, duke lënë në to gjurmët e besimit.

Xhamia "Mbret" Q-01

Në anën perëndimore në qoshen e murit të hajatit në xhaminë Mbret, janë murosur 2 fragmente reliefi (fig.22) të së njëjtit monument. Korniza e tyre përmban simbolin e vezës dhe shigjetës, karakteristikë e përdorimit të tyre në frizet dhe (kapitelet jonike shih fig.11) të ndërtimeve të periudhës së vonë antike. Brenda kornizës së tyre nga një motiv ylli me tetë cepa. Si kohë reliefet i përkasin periudhës së vonë antike dhe të një ndërtimi monumental. Mendojmë se murosja e kësaj plastike dekorative arkitektonike kushtëzohet nga rindërtimi i hajatit të xhamisë Mbret në gjysmën e parë të shek.XIX.

Pranë kodrës së kalasë së Beratit

Në një kodër me ullinj, pa mbërritur në fshatin Parangua, pranë kodrës së kalasë së Beratit, në veri-lindje të saj rreth 1800 m, kemi dokumentuar fragmentet e dy kolonave (fig.23) dhe një tjetër element arkitektonik, pilastër i kangjellës së sanktuarit (fig.24) që gjejnë përdorim në kishat e hershme bizantine. Në gjendjen e sotme pranë sipërfaqes së kishës dhe strukturave të saj, është vendosur një shtyllë e tensionit të lartë. (Dritan Çoku, Gjurmë e një sinagoge në kalanë e Beratit, bocet, Berat, 2012, f.44)

Studimi i monumenteve paleokristiane ndihmon në ndriçimin e mjaft problemeve të nivelit të zhvillimit të shoqërisë ilire në shekujt e fundit të Antikitetit. (Aleksandër Meksi, Arkitektura e kishave të Shqipërisë shek. VII-XV, UEGEN, Tiranë, 2004, f.41)

Një dëshmi tjetër që të shtyn akoma më shumë në kohë më të hershme është edhe një kapitel dorik (fig.25) që është i ekspozuar në një kompleks shërbimi pranë kalasë. Bashkohem me mendimin e Prof.Samimit se në kohët e lashta ne Kalanë e Beratit duhet të ketë patur Tempull, por për plotësimin dhe saktësimin përfundimtar të këtij mendimi është e nevojshme vërtetimi shkencor me anë të gërmimeve arkeologjike dhe me analiza konkrete laboratorike moderne të kohës së sotme mbi periudhën, moshën e përdorimit të këtyre elementëve të përdorura në ndërtimet e hershme.

Zhvillimi i qytetit të Beratit në mesjetë dhe vazhdimësia e banimit të tij deri në ditët e sotme e kanë kufizuar mjaft sipërfaqen e lirë të mundshme për gërmim dhe në këtë mënyrë kanë vështirësuar shtrirjen e gërmimeve arkeologjike në një territor më të gjerë. Megjithatë duhet thënë se brenda mundësive që lejojnë gërmimet relativisht të kufizuara të bëra vetëm në zona të lira dhe të pabanuara të kalasë është e vështirë të zgjidhen të gjitha problemet që lidhen me këtë qytet. (Hëna Spahiu, Qyteti Iliro-Arbëror i Beratit, Mihal Duri, Tiranë, 1990, f.7) Kjo nuk do të thotë se nuk mund të plotësohen në të ardhmen, prandaj paraqitja e këtyre dëshmive të reja ka për qëllim t'i evidentojë për një studim më të plotë të kësaj pasurie në të ardhmen, por edhe të ndihmojë në gjurmimin dhe zbulimin e ndërtimeve të zhdukura në kalanë e Beratit me anë të gërmimeve sistematike arkeologjike.

SHËNIM

Studimi i këtij koleksioni jep një informacion me vlerë historike, kulturore e arkitektonike. Kohë më parë, pranë grykës së ngushtë që krijoi lumi, lindi një qendër e banuar, e cila më vonë u kthye në qytet. Ky është Berati.